



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA VIII
Sesioni pranveror

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis, Planifikim Hapësinor dhe Infrastrukturë
Mbledhja nr. 12
Prishtinë, më 2.7.2021, në orën 9:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Fitore Pacolli-Dalipi, Besian Mustafa, Milazim Salijaj, Ekrem Mustafa, Arbëreshë Kryeziu- Hyseni, Fadil Nura, Salih Zyba dhe Samra Ilijazi.

Munguan: Bekim Haxhiu, Zoran Mojsiloviç, Albena Reshitaj.

Pjesëmarrës të tjerë: Edolind Bytyçi, praktikant, Bjondina Çanta dhe Fitore Berisha.

Stafi mbështetës i komisionit: Bajram Badivuku.

Mbledhjen e kryesoi, **Fitore Pacolli-Dalipi, kryetare e komisionit.**

Në këtë mbledhje u propozua ky

rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-132 për automjete;
3. Debati rreth mundësisë së shkarkimit të Bordit të Autoritetit Rregullator të Hekurudhave;
4. Të ndryshme.

Kryetarja konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

Kryetarja propozoi pikën shtesë 4, të bëhet një përmbledhje e një raporti për punën e komisionit, në mënyrë që ky raport të prezantohet edhe para mediave.

1. Miratimi i rendit të ditës

Komisioni miratoi rendin e ditës.

2. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-132 për automjete

Kryetarja, sipas njohurive nga administrata, konstatoi se ende nuk kanë kaluar 14 ditë pune, që të bëhet shqyrtimi i Projektligjit për automjete, andaj duhet të presim që të plotësohet afati, se mund të ketë kërkesa që të fillojë procesi prej fillimit. Ajo hapi diskutimin dhe ftoi deputetët për të prezentë, nëse ka propozime rreth kësaj çështjeje.

Besian Mustafa, sugjeroi që pas nenit 4, të shtohet neni sipas të cilit, neni 89 i ligji bazik për automjete, të plotësohet dhe të ndryshohet, duke fshirë në tërësi paragrafin 2 dhe 3.

Paragrafi 2 i nenit 89 i ligjit bazik përcakton : *Nuk mund të licencohet asnjë subjekt i ri apo linjë e re për kontroll teknik, nëse mesatarja e numrit të kontrolleve teknike të të gjitha subjekteve për kontroll teknik brenda territorit të një komune nuk ka kaluar katër mijë (4000) kontrolle brenda vitit.*

Ndërsa, paragrafi 3 i e nenit 89 përcakton: *Kontrolli teknik i mjeteve mund të bëhet vetëm brenda komunës, ku e ka vendbanimin pronari i mjetit. Nëse brenda komunës nuk ka subjekte për kontroll teknik, atëherë kontrolli bëhet brenda rajonit, ku e ka vendbanimin pronari i mjetit.*

Më tutje, z. Mustafa tha se këta dy paragrafë bien ndesh me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, posaçërisht me nenin 119, paragrafët 1, 2 dhe 3.

Salih Zyba, tha se zgjidhja e këtij neni bëhet përmes ndryshimeve rrënjësore të ligjit. Ky paragraf duhet të shikohet për arsye se ka një kohë të gjatë që është normuar në këtë mënyrë. Ky nuk mund të quhet monopol, por është përkufizim, normë e caktuar mbi bazën e qarkullimit të automjeteve. Duhet të ketë një raport se a duhet të ndryshohet numri i automjeteve apo të hapet pa kufizim cilësia. Pra, duhet të kemi të dhëna shtesë prej ministrisë, të hapet si tërësi apo të kërkojmë nga ministria të ketë një kalkulim tjetër. Unë jam për të lëvizur, por të hiqet me automatizëm, krijon një përmbysje tjetër.

Besian Mustafa, tha se në parim, me Salih Zybën është me të njëjtin mendim, nëse po vendosim që të largojmë në tërësi homologimin, në të njëjtën mënyrë propozoi që të largohen këto dy nene që kufizojnë aktivitetin ekonomik.

Ekrem Mustafa, tha se nuk është monopol, por një përkufizim në këto 4000 automjete, siç po funksionon sistemi në Kosovë, gjendja nuk është e mirë dhe kontrolli nuk është i mjaftueshëm nëpër kontrolle teknike. Kontrollat teknike nganjëherë nuk janë në nivelin e duhur, andaj edhe mund të zgjidhet një komunë tjetër, ku mundësia e manipulimit është më e madhe, mendoj të shtyjme edhe për një kohë, derisa ministria të japë rekomandime.

Kryetarja, tha se ne si komision duhet ta rishikojmë dhe ta trajtojmë ligjin në tërësi, ngase duhet ta shikojmë aspektin e sigurisë, aspektin e gjendjes ekonomike që e kanë qytetarët, edhe iniciativat që Qeveria ka për veturat hibride, ngase shteti ynë duhet të shkojë drejt elektrifikimit të automjeteve. Mendoj që ne si komision duhet t'i bëjmë kërkesë Qeverisë apo ministrisë përkatëse, që ta trajtojë me prioritet këtë ligj edhe të silltet një ligj i ri dhe pastaj në ligjin e ri të punojmë në detaje për të gjitha aspektet që nevojiten.

Besian Mustafa, tha se propozimi im nuk ka të bëjë për largimin e kriterëve apo standardeve për kontrollin teknik, por për largimin e kufizimeve artificiale. Pra, 4000 kontrolle brenda vitit në një komunë, pastaj të hapet një kontroll e re teknike, e konsideroj si kufizim artificial. Mendoj se ky numër i kontrolleve teknike të jetë 0 (zero), pra të ketë konkurrencë të lirë.

Salih Zyba, tha se kjo shifër përshtatet apo përputhet me kapacitetin që lejohet ligjërisht, futja në funksion për kontroll teknik e ka edhe minutazhin e caktuar, përveç vëzhgimit edhe kriterëve tjera të nënshtrimit, por për ta hequr ose ta ndryshuar duhet të ketë një analizë. Propozoj që vizita jonë e terrenit të jetë në njërin nga kontrollet teknike. Krahas kërkesës në ministri, që e bëjmë për të na sjellë shifrat apo të dhëna përmes QAK, unë kërkoj që vizita në terren të jetë në homologim dhe në kontroll teknik. Në vizitë apo me konstatim në vendngjarje, më drejtpërdrejt shohim edhe ndikimin edhe efektet, ku numri i kontrolleve teknike në një komunë është më i madh se 4000, që nënkupton se duhet të ketë më shumë se një operator për kontrolle teknike. Por kontrollit teknik, duhet të kemi shifrat e sakta të automjeteve të regjistruara në atë komunë.

Besian Mustafa, tha se jam për hapjen dhe licencimin e një pike të re të kontrollit teknik, nuk mund të ketë një pikë të kontrollit teknik e cila nuk i zbaton ligjet apo kriteret, qofshin më të lartat në nivel ndërkombëtar, mirëpo kufizimet ekonomike të natyrës se në komunën x duhet të ketë x vetura për të hapur një pikë të re, në parim i kundërshtoj, jam për konkurrencë të lirë.

Kryetarja, tha se ka pasur diskutime me zyrtarët e Bashkimit Evropian dhe zyra e përfaqësuesit të Bashkimit Evropian ka caktuar dy ekspertë për konsultim me komisionin tonë, andaj propozoj të hyjmë në detaje dhe ta mbikëqyrim këtë ligj, të shohim se ku janë mangësitë.

Salih Zyba, propozoi që të krijohet një grup punues.

Ekrem Mustafa, tha se do të ishte mirë që ekspertë të caktuar të vinin në komision dhe të na ndihmojnë rreth këtij projektligji.

Fadil Nura, tha se kemi sistemin juridik-kushtetues që rregullon dyshkallshmërinë mes autoriteteve lokale dhe qendrore. Një komunë është përgjegjëse për banorët e saj dhe i përgjigjet nevojave të atyre banorëve. Kjo ndërlidhet edhe me aspektin e zhvillimit ekonomik, pavarësisht se këtë shërbim qytetari mund ta bëjë ku të dojë, por duhet të shikohet edhe në aspektin e sigurisë dhe a ndërlidhet me dhënien e tabelave të regjistrimit, përkatësisht te numri i tabelës, ku numrat janë të ndarë në rajone. Unë personalisht jam për analizë më në detaje të këtij ligji.

Besian Mustafa, tha se një dokument bazik mund ta tërheqim në cilën do komunë, p.sh një certifikatë të lindjes apo ekstrakt të lindjes mund ta marrim në cilën do komunë pra një qytetarë i Komunës së Prizrenit mund ta marr një dokument në Komunën e Mitrovicës, por në anën tjetër nuk po e përkrahim të njëjtën ide për një shërbim tjetër.

Salih Zyba, tha se një kërkesë konkrete ka qenë e kompanive që kanë pajisje të rënda dhe me lokacione të ndryshme. Kam kontaktuar me shumë persona, por edhe organizata ku padrejtësisht u kufizohen këto të drejta, andaj këto ndryshime janë të nevojshme.

Operatori që e ka monopolin në Kosovë, është përpjekë për të kamufluar monopolin përmes nënkontraktorëve, pra në rajone tjera ka dërguar nënkontraktorë, por jo hapje të reja.

Kryetarja, pas diskutimeve, ftoi deputetët që të paraqiten se kush dëshiron që të jetë pjesë e grupit punues që do të punojë në këtë projektligj.

Grupi punues për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.05/L-132 për automjete: 1. Besian Mustafa-kryesues, 2. Salih Zyba- anëtar, 3. Ekrem Mustafa-anëtar.

3. Debati rreth mundësisë së shkarkimit të Bordit të Autoritetit Rregullator të Hekurudhave

Kryetarja, tha se pika e radhës e rendit të ditës që ka qenë propozim i deputetit Salih Zyba, është shkarkimi i Bordit të Autoritetit Rregullator të Hekurudhave.

Salih Zyba, tha se në vlerësimin që e kemi bërë, shumica nga ne, në raportimin që ka qenë dhe diskutimin që e kemi bërë, e në formën e vlerësimit negativ të punës që ja kemi dhënë këtij Autoriteti, konsideroj se sot është çështje vetëm e votimit.

Fadil Nura, tha se e kemi analizuar edhe raportin e auditorit për këtë bord, i cili ka qenë një prej më të mirëve. Unë jam kundër shkarkimit të Bordit të Autoritetit të Hekurudhave të Kosovës.

Besian Mustafa, tha se procesi i emërimit të anëtarëve të Bordit është në atë mënyrë ku secili aplikon dhe zgjidhet veç e veç, prandaj siç kanë qenë vlerësimet individuale, ku këta anëtarë Bordi janë përzgjedhur, mendoj se edhe vlerësimet duhet të jenë individuale mbi performancën e tyre dhe do të parapëlqejë të kemi një shqyrtim dhe vlerësim të anëtarëve të Bordit, veç e veç, dhe të votimit për secilin anëtar, veç e veç.

Kryetarja, tha se kemi pasur mbledhje me Bordin dhe secili ka pasur mundësi të flasë dhe të arsyetojë punën apo mospunën e tij. Unë nuk kam arritur të bëj dallimin se cili ka performuar më mirë, sepse puna e Bordit ka qenë grupore dhe asnjëri nuk ka qenë në gjendje t'i arsyetojë dështimet që i kanë pasur si Bord. Shqetësuese është rënia e numrit të udhëtarëve, siguria, numri i viktimave, aksidentet që janë shkaktuar dhe po ashtu numri i vendkalimeve ilegale dhe ende nuk është ndërmarrë asnjë veprim, sa i përket Bordit.

Salih Zyba, e konsideroj si obligim moral, që për njërin prej anëtarëve të Bordit që nuk ka qenë fizikisht aty, sa i përket vlerësimit të folësve aty, që e kanë arsyetuar mospunën, por e kam

kërkuar një shpjegim prej kolegëve të tij, andaj nëse ka forma që i njëjti të rikthehet ose forma të eliminimit nga ky përfaqësim, vetëm po citoj nenin 38 që përcakton se Kuvendi emëron 4 anëtarët.

Ne si anëtar të Komisionit nuk po e shkarkojmë Bordin, vetëm po e adresojmë shkarkimin e tyre, sa i përket anëtarit të Bordit që nuk ka qenë prezentë, kolegët e tij kanë thënë se për një kohë të gjatë nuk është mirë me shëndet, që domethënë se ai kontributin e vet nuk e ka dhënë në atë Bord.

Kryetarja theksoi se cilido anëtar i bordeve në të kaluarën që kanë punuar në mënyrë të drejtë dhe kanë qenë korrekt në punën e tyre, askush nuk mund t’ia mohojë të drejtën që të aplikojnë dhe të zgjidhen përsëri, sepse vetë puna e atij personi edhe gjatë intervistës, edhe ndonjë procesi tjetër transparente, do të dëshmohej përfshirë mosangazhimin e tij, për shkak të gjendjes shëndetësore.

Fadil Nura, tha se këto janë vlerësime politike, nëse e marrim aspektin profesional rënien e udhëtarëve, nëse mendoni se një Bord tjetër mund të ndikojë në rritjen e numrit të udhëtarëve, duke marrë parasysh parametrat e zhvillimit të transportit në Republikën e Kosovës, atëherë është diçka tjetër. Nëse e ndërlihim edhe problemet me veriun, mendoj se secili Bord do të ketë vështirësi t’i zgjidhë. Më pas, propozoi që kjo çështje të hidhet në votim.

Besian Mustafa, theksoi se mospajtimi im është ashtu siç janë vlerësuar një nga një si anëtar Bordi, t’i vlerësojmë një nga një si anëtar Bordi, pastaj votimin ta bëjmë për secilin anëtar Bordi.

Salih Zyba, tha edhe po të kishim argumentin procedural do ta shqyrtonim, por nuk është praktikë e as argument kjo që po e kërkon në këtë rast.

Kryetarja, pas diskutimeve, ftoi deputetët për votim dhe konstatoi se komisioni, me 6 vota për, 1 kundër dhe 1 abstenim, vendosi që Kuvendit t’ia paraqesë këtë:

Rekomandim

Të shkarkohet Bordi i Autoritetit Rregullator të Hekurudhave:

- 1. Arsim Berisha- kryesues,**
- 2. Gëzim Qerimi-anëtar,**
- 3. Shkumbin Hyseni-anëtar,**
- 4. Ilmi Ahmeti-anëtar.**

Kryetarja, tha se te pika e katërt e rendit të ditës (Të ndryshme), është propozimi im që të bëjmë një raport përmbledhës të punës së komisionit dhe bashkërisht të prezantojmë në konferencë për media ose mund vetëm ta publikojmë si komision.

Salih Zyba, tha fillimisht duhet të kemi draftin, ta analizojmë, më pas është mënyra se si e shfaqim si përmbledhje, duhet të kemi diskutim pastaj është mënyra e raportimit.

Mbledhja përfundoi në orën 10:00.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetarja e komisionit,

Fitore Pacolli-Dalipi